



RAPORTI I MONITORIMIT

PËR VITIN 2025

I STRATEGJISË AFATMESME TË MENAXHIMIT TË BORXHIT

2022-2026

Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Shtetëror

Tiranë, Mars 2026

PËRMBAJTJA

I. Parathënie	3
II. Zhvillimet Makroekonomike gjatë vitit 2025.....	4
III. Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit	5
IV. Realizimi i Objektivave të SAMB-Viti 2025	6

I. Parathënie

Raporti i Monitorimit të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit përgatitet në përputhje me Nenin 6 të Ligjit Nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky Raport Monitorimi përgatitet nga Ministria e Financave dhe i dërgohet Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat si dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave.

Në vitin 2022, Ministria e Financave përditësoi strategjinë e menaxhimit të borxhit, duke miratuar dhe publikuar Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2022-2026¹, e cila ka qenë në zbatim deri në fund të vitit 2025. Ndërkohë, gjatë vitit 2025 Ministria e Financave përditësoi strategjinë duke miratuar dhe publikuar në muajin Dhjetor Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2026-2030, e cila fillon zbatimin nga viti 2026.

Në përputhje me Ligjin Nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministria e Financave brenda tremujorit të parë të çdo viti harton një Raport Monitorimi për Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit për vitin paraardhës, raport i cili paraqet një analizë mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit për atë vit. Publikimi i këtij raporti përbën një hap pozitiv në drejtim të rritjes së transparencës ndaj publikut të gjerë, si dhe intensifikimit të komunikimit me investitorë apo palë të treta të interesuara.

Ky raport parashtron në vijim në mënyrë të detajuar arritjet në drejtim të treguesve të matshëm të riskut, ku mund të theksohet se të gjithë indikatorët shënojnë tejkalim të objektivave të përcaktuar në strategji, si dhe zhvillimet sa i takon objektivave të tjera jo të matshme.

Treguesit e riskut të rifinancimit janë përmirësuar ndjeshëm. Jetëgjatësia mesatare e borxhit të brendshëm në fund të vitit 2025 është rritur me 79 ditë, krahasuar me fundin e vitit 2024 duke arritur në 1002 ditë (apo 2.8 vite), ndërkohë që krahasuar me fundin e vitit 2021 ky tregues është rritur me 209 ditë. Risku i kursit të këmbimit është përmirësuar gjithashtu në një masë të konsiderueshme. Konkretisht, pesha e borxhit në valutë të huaj ndaj stokut të borxhit total rezultoi 40.0% në fund të vitit 2025, duke u ulur me 1.9 p.p krahasuar me fundin e vitit 2024, si dhe është ulur me 9.8 p.p, krahasuar me fundin e vitit 2021.

Në të njëjtën mënyrë, edhe treguesit e tjerë të matshëm tregojnë përmirësime domethënëse, duke shënuar kështu një pëmbyllje me sukses në këtë aspekt të Strategjisë që ishte në fuqi deri në fund të vitit 2025.

¹ <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/2022-2026-Strategjia-Afetmesme-e-Menaxhimit-te-Borxhit.pdf>

II. Zhvillimet Makroekonomike gjatë vitit 2025

Ekonomia shqiptare ka demonstruar një qëndrueshmëri të lartë përballë goditjeve të njëpasnjëshme gjatë viteve të fundit, ndërsa politikat e kujdesshme makroekonomike dhe fiskale kanë mbështetur ruajtjen e stabilitetit dhe rimëkëmbjen graduale të aktivitetit ekonomik. Rritja ka vijuar të tejkalojë pritshmëritë, përfshirë edhe vitin 2025, i cili konsolidoi këtë trend falë performancës së fortë të sektorit të shërbimeve veçanërisht turizmit si dhe ndërtimit, të mbështetur nga konsumi i brendshëm, investimet dhe eksportet e shërbimeve. Perspektiva afatmesme mbetet pozitive, duke reflektuar elasticitetin e ekonomisë dhe aftësinë e saj për t'u përshtatur dhe rikuperuar përballë kushteve sfiduese.

Zhvillimet ekonomike në vend gjatë vitit 2025 u ndikuan nga ecuria e ekonomisë globale, sidomos asaj të Bashkimit Evropian. Aktiviteti botëror vazhdoi të rikuperohej, por rritja mbeti e moderuar, ndërsa inflacioni ra gradualisht në nivele më të qëndrueshme. Këto kushte mundësuan vijimin e lehtësimit të politikës monetare në ekonomitë e mëdha, me BQE-në që zgjeroi ciklin e uljes së normave bazë nisur në fund të vitit 2024. Reagimi i inflacionit, aktivitetit ekonomik dhe tregut të punës ndaj këtij cikli ka qenë përcaktues për orientimin e politikave monetare gjatë vitit. Në nivel rajonal, inflacioni u ngadalësua dukshëm gjatë 2025-ës, ndërsa rritja ekonomike mbeti e ngjashme me atë të vitit 2024.

Gjatë vitit 2025, ekonomia e vendit arriti të përballojë dhe të amortizojë plotësisht efektet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, pa devijuar nga trajektorja e rimëkëmbjes dhe pa cenuar ekuilibrat makroekonomikë apo stabilitetin financiar. Inflacioni në vitin 2025 u stabilizua në një mesatare vjetore prej 2.2%, duke vijuar trajektoren rënëse të filluar një vit më parë. Moderimi i inflacionit u mundësua kryesisht nga zbutja e presioneve të jashtme inflacioniste, forcimi i kursit të këmbimit të lekut dhe ndikimi i politikës normalizuese monetare. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë vijoi të mbajë të pandryshuar normën bazë në nivelin 2.5%. Ky orientim synon konsolidimin e stabilitetit të çmimeve dhe mbështetjen e kthimit të inflacionit drejt objektivit në periudhën pasuese.

Rritja ekonomike dhe tregu i punës kanë pasur një ecuri pozitive në vitin 2025. Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2025, PBB-ja u zgjerua me rreth 3.7%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rritja është gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet. Rritja ekonomike për vitin 2025 vlerësohet të jetë rreth 3.9%, si rezultat i një sezoni veçanërisht të fuqishëm turistik, përmirësim i performancës në sektorin e ndërtimit, pasurive të paluajtshme dhe energjisë. Përsa i përket perspektivës afatmesme, rritja ekonomike parashikohet mesatarisht rreth 4.0% në vit përgjatë periudhës afatmesme në vijim 2026-2028.

Konsolidimi fiskal do të vijojë të jetë objektivi themelor i politikës fiskale për periudhën afatmesme 2026-2028, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit

makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse. Gjatë periudhës afatmesme, politika fiskale do të vazhdojë të targetojë një trajektore rënëse të përvitshme të borxhit publik, që vetëm përgjatë vitit 2025, vlerësohet të ketë shënuar një rënie 1.2 p.p., duke arritur në nivelin prej 53.0% të PBB.

III. Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit

Ministria e Financave gjatë vitit 2025 ka patur në zbatim Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2022-2026, cila është miratuar nga Këshilli i Ministrave, nëpërmjet VKM me Nr. 534, datë 29.07.2022 “Për miratimin e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2022-2026”.

Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit 2022-2026 është në funksion të objektivave të përgjithshme të menaxhimit të borxhit të specifikuar në ligjin Nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe është në linjë me kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal dhe me politikën monetare të Bankës së Shqipërisë.

Kjo Strategji mbulon menaxhimin e Borxhit të Qeverisjes Qendore, në të cilin përfshihet Borxhi Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore të Huasë. Qëllimi i saj është të orientojë huamarrjen drejt instrumenteve me kosto të favorshme dhe me nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj riskut për nivele të caktuara të financimit. Nivelet e financimit përcaktohen në kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal dhe në Planin Afatmesëm Buxhetor të ndarë në plane/volume vjetore të huamarrjes.

Në hartimin e Strategjisë janë marrë në konsideratë raportet kosto-risk të portofolit ekzistues, si dhe zhvillimi i këtyre raporteve bazuar në një analizë sasiore të realizuar për një numër skenarësh (strategji) alternativë të financimit, shkalla e ekspozimit të borxhit ndaj risqeve dhe shkalla e zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë. Krahas strategjisë bazë, e cila i referohet skenarit më të mundshëm të financimit, në Strategjinë e Menaxhimit të Borxhit janë parashtruar edhe disa strategji alternative financimi, duke vlerësuar për çdo rast ndikimet e mundshme mbi kostot, risqet dhe shkallën e zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë.

IV. Realizimi i Objektivave të SAMB-Viti 2025

IV.1 Ecuria e objektivave të përgjithshme të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2022-2026.

IV.1.1. *Plotësimi i nevojave të qeverisë për financim në kohë, si edhe nevojave për të shërbyer borxhin aktual me kosto sa më të ulët duke mbajtur nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj risqeve*

Viti 2025 ka qenë një vit mjaft pozitiv për sa i përket sigurimit të financimit, si në tregun e brendshëm dhe në atë të huaj. Huamarrja u realizua në përputhje me Planin Vjetor të Huamarrjes për vitin 2025, si edhe në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2022-2026. Gjatë vitit 2025, huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 454.0 miliard Lekë, nga të cilat 78.2% (ose 355.2 miliard Lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 21.8% (ose 98.8 miliard Lekë) nëpërmjet burimeve të huaja.

Tabela 1: Realizimi i Huamarrjes


Burimet e Huamarrjes	2024		2025	
	Vlera (në mld Lekë)	%/Total	Vlera (në mld Lekë)	%/Total
Burime të Brendshme	378.4	93.6%	355.2	78.2%
Bono Thesari	196.7	48.7%	186.2	41.0%
Obligacione	181.7	45.0%	169.1	37.2%
Burime të Jashtme	25.8	6.4%	98.8	21.8%
Hua për financimin e projekteve	13.0	3.2%	22.7	5.0%
Mbështetje Buxhetore	12.9	3.2%	13.1	2.9%
Eurobond	-	0.0%	63.1	13.9%
Total Huamarrja	404.2	100.0%	454.0	100.0%

Burimi: Ministria e Financave, 2026

Qeveria emetoi 355.2 miliard Lekë tituj shtetërorë në tregun e brendshëm, nga të cilët 186.2 miliard Lekë Bono Thesari dhe 169.1 miliard Lekë Obligacione.

Në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë vitit 2025 është rritur frekuenca dhe vlera e emetimeve të instrumenteve afatgjata dhe si rrjedhojë borxhi i ri është mundësuar tërësisht nëpërmjet titujve afatgjatë, si edhe është shoqëruar me maturime të instrumenteve afatshkurtër. Kërkesa për tituj shtetërorë ka qenë më e lartë se oferta e Qeverisë pothuajse në të gjitha ankandet e realizuara gjatë vitit dhe huamarrja neto në tregun e brendshëm në fund të vitit 2025 rezultoi 49.4 miliard Lekë. Nga totali i financimit neto, 60.0 miliard Lekë financim neto është realizuar nëpërmjet obligacioneve, ndërsa sa i takon instrumenteve afatshkurtër, financimi neto rezulton negativ prej -10.6 miliard Lekë, që do të thotë se gjatë vitit 2025 janë maturuar instrumente afatshkurtër më shumë se sa janë emetuar.

Grafik 1: Huamarrja e brendshme neto muaj pas muaji²



Burimi: *Ministria e Financave, 2026*

Sa i takon burimeve të jashtme të financimit, huamarrja gjatë vitit 2025 u realizua në nivelin prej 98.8 miliard Lekë. Peshën më të madhe në huamarrjen e huaj gjatë këtij viti e mban Eurobondi me masë 63.8%, pjesa tjetër nëpërmjet disbursimit të huave për projekte kryesisht në, transport, infrastrukturë urbane dhe furnizim me ujë dhe kanalizime, në masën në masën 23.0% dhe nëpërmjet disbursimit të huave në formën e mbështetjes buxhetore në masën 13.2%.

Kosto


Për sa i përket raporteve të kostos dhe riskut në portofolin e borxhit, portofoli i borxhit është arritur të menaxhohet në mënyrë të përshtatshme, duke mbajtur koston në nivelin më të ulët të mundshëm sipas kushteve të tregut, ndërkohë indikatorët e riskut kanë shfaqur përmirësim në të gjithë treguesit.

Për vitin 2025, shpenzimet për interesa të borxhit përllogariten në vlerën prej 54.7 miliard Lekë, përkatësisht 35.2 miliard Lekë për interesa të borxhit të brendshëm dhe 19.5 miliard Lekë për interesa të borxhit të jashtëm. Ripagesat e borxhit të jashtëm për vitin 2025 ishin 90.3 miliard Lekë (pagesa për principalin). Gjatë vitit 2025 pati dy maturime të rëndësishme të dy instrumenteve, si Eurobond i emetuar në vitin 2018, ku u maturua vlera e mbetur e tij prej rreth 367 mln Euro, si dhe u pagua kredia prej 200 mln Euro e siguruar në vitin 2015 me një Garanci të bazuar në politika nga Banka Botërore.

Krahasuar me vitin 2024 shpenzimet për interesa u rritën me 0.2 miliard Lekë (0.4% më shumë se viti 2024). Rritja ka qenë kryesisht në kategorinë e instrumenteve të tregut të brendshëm, si rezultat i rritjes së huamarrjes në tregun e brendshëm, për t'ju përshtatur kërkesës së rritur në tregun e brendshëm, si dhe përqëndrimin e saj në kategorinë e instrumenteve afatgjata. Shpenzimet faktike për interesa kanë qenë brenda fondit të parashikuar në Buxhetin e Vitit 2025.

² Është llogaritur financimi neto për çdo muaj i ndarë nga muajt paraardhës.

Grafik 2: Shërbimi i Borxhit 2020-2025



Burimi: Ministria e Financave, 2026

IV.1.2. Përmirësimin dhe ruajtjen e eficientësisë së tregut primar, mbështetur nga zhvillimi i mëtejshëm i tregut sekondar të titujve shtetërorë vendas

Gjatë vitit 2025 kërkesa për tituj shtetërorë ka qenë në nivele të kënaqshme, duke tejkaluar ofertën e Qeverisë për tituj. Raporti i mbulimit ka qenë mbi 1 në pothuajse të gjithë ankandet e realizuara si në kategorinë e titujve afatshkurtër dhe në kategorinë e titujve afatgjatë. Investitorët vendas (rezidentë) vijojnë të jenë mbështetja kryesore e kërkesës për tituj shtetërorë, ndërsa sektori bankar mbetet burimi kryesor i kërkesës, duke ruajtur një peshë mbi 60%.

Në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës së tregut primar dhe stimulimit të tregut sekondar, kanë vazhduar të ndërmerren aktivitete, të cilat kanë pasur si objektiv reduktimin e fragmentimit të kërkesës, si dhe konsolidimin e madhësive *benchmark* për titujt afatgjatë. Titujt referencë 3 dhe 5 vjeçar janë emetuar me sukses në dy linja emetimi gjatë vitit 2025: konkretisht Obligacioni referencë 3 vjeçar është emetuar në shumën totale 32.1 miliard Lekë dhe Obligacioni referencë 5 vjeçar është emetuar në shumën totale 41.1 miliard Lekë.

Në drejtim të krijimit të madhësive *benchmark* është vijuar me konsolidimin e numrit të ankandëve të titujve shtetërorë, duke ulur frekuencën e emetimeve të titujve të rinj dhe duke përdorur rihapjet e titujve ekzistues. Në total gjatë vitit 2025 janë realizuar 82 ankande, nga të cilët 26 ankande për tituj afatshkurtër dhe 56 ankande për tituj afatgjatë.

IV.1.3. Zhvillimi i tregut të titujve shtetërorë

Zhvillimi i tregut të titujve shtetërorë ka pasur si qëllim kryesor realizimin e aktiviteteve të fokusuara në: a) rritjen e likuiditetit, b) rritjen e eficientësisë, dhe c) rritjen e transparencës.

Këto objektiva janë pjesë e një procesi afatgjatë, ndërkohë që zhvillimi i aktiviteteve dhe implementimi i masave të ndryshme ka nisur dhe do të vijojë të forcohet dhe zhvillohet më tej. Gjatë vitit 2024, Ministria e Financave ka realizuar për herë të parë vlerësimin e 5 bankave zhvilluese të tregut për vitin 2023, për të vijuar më tej me vlerësimin e performancës së vepritarisë së bankave çdo 6-muaj. Ky vlerësim është realizuar në përputhje me Metodologjinë për Vlerësimin e Bankave Zhvilluese të Tregut (Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 07.11.2022).

Qëllimi i këtij dokumenti është të përshkruajë metodologjinë standarde që ndjek Ministria e Financave për vlerësimin dhe monitorimin periodik të performancës së 5 bankave zhvilluese të tregut (Market Maker) në lidhje me titujt shtetërorë referencë. Ky vlerësim kontribuon në zhvillimin e mëtejshëm të tregut të titujve të Qeverisë, stimulimin e tregut sekondar dhe rritjen e likuiditetit. Rezultatet e vlerësimit të bazuara në këtë metodologji janë përmbledhur në një raport të konsoliduar për vitin 2023, i cili është ndarë me bankat pjesëmarrëse dhe aktorë të tjerë. Me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të tregut të titujve të qeverisë, duke filluar nga muaji Korrik 2024, është shtuar si pjesë e programit të zhvilluesve të tregut edhe një bankë, duke e çuar në gjashtë numrin total të bankave zhvilluese të tregut.

Në vijim të monitorimit të vazhdueshëm të performancës së këtyre bankave, janë realizuar dhe 2 vlerësimet 6-mujore për vitin 2025, raporte të cilat janë diskutuar dhe janë ndarë me bankat.

IV.1.4. Hartimi dhe publikimi i një plani vjetor huamarrje

Ministria e Financave ka hartuar dhe publikuar në muajin Dhjetor 2025 Planin Vjetor të Huamarrjes për vitin 2026, dokument që ka filluar të hartohet prej vitit 2022 me synimin kryesor rritjen e transparencës së Ministrisë së Financave në procesin e huamarrjes dhe sigurimit të financimit si dhe informimin e vazhdueshëm të investitorëve.

Plani Vjetor i Huamarrjes për vitin 2026 paraqet detajet e instrumenteve që do të emetohen në tregun e brendshëm, përfshirë emetimet përkatëse të çdo instrumenti dhe frekuencën e emetimit të tyre. Po ashtu, planifikon huamarrjen në tregun e huaj, duke specifikuar vlerën e huamarrjes së huaj për vitin 2026 dhe instrumentet që do të përdoren.

Bazuar në Planin Vjetor të Huamarrjes për vitin 2026, do të hartohen dhe kalendarët tremujorë të huamarrjes në tregun e brendshëm. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se Ministria e Financave rezervon të drejtën për të ndryshuar frekuencën ose shumën e emetuar për çdo instrument/muaj, duke u përshtatur me kushte të ndryshueshme të tregut.

IV.1.5. Vlerësimi i mundësisë së përdorimit të alternativave të reja të burimeve të financimit (Green, Sociale etj)

Në vazhdim të nismës së iniciuar gjatë vitit 2022, edhe gjatë vitit 2025, Ministria e Financave ka vlerësuar mundësitë e përdorimit edhe të alternativave të reja të financimit, përveç burimeve tradicionale të huamarrjes. Për këtë arsye, janë organizuar disa takime me përfaqësues të Bankës Botërore për sa i përket detajeve të këtyre instrumenteve avantazheve/disavantazheve, mundësinë e implementimit, procedurat dhe kushtet për implementimin e tyre etj.

Në kushtet ku këto lloje instrumentesh paraqesin një tërësi të panjohurash, Ministria e Financave do vijojë të eksplorojë në drejtim të njohjes sa më të plotë të parakushteve, përfitimeve dhe përshtatshmërisë apo gatishmërisë së vendit tonë për të avancuar me iniciativa të emetimit në tregjet e kapitalit të instrumenteve të financimit green apo sociale.

Nga këndvështrimi mjedisor dhe social, Ministria e Financave ka ndërmarrë hapa konkrete në drejtim të sigurimit të një ndërgjegjësimi më të lartë të impaktit mjedisor dhe social, me rishikimin e procedurave të menaxhimit të investimeve publike. Në muajin dhjetor 2022 janë miratuar nga Këshilli i Ministrave, nëpërmjet Vendimit Nr. 887 datë 27.12.2022, procedurat e reja të menaxhimit të investimeve publike, të cilat, në tërësinë e përmirësimeve që sjellin në këtë fushë, parashtrojnë një qasje të avancuar sa i takon impaktit mjedisor, klimaterik dhe atij social të projekteve të investimeve. Çdo projekt i mundshëm investimi që synohet të financohet, do të vlerësohet duke konsideruar gjithashtu, si një element/parim të rëndësishëm, edhe vlerësimin mjedisor dhe impaktin klimaterik.

Tabela 2: Ecuria e Objektivave të Përgjithshme

	Objektiva të përgjithshë cilësorë	2022	2023	2024	2025	2026
1	Plotësimi i nevojave të qeverisë për financim në kohë, si edhe nevojave për të shërbyer borxhin aktual me kosto sa më të ulët duke mbajtur nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj risqeve	✓	✓	✓	✓	
2	Përmirësimin dhe ruajtjen e efencës së tregut primar, mbështetur nga zhvillimi i mëtejshëm i tregut sekondar të titujve shtetërorë vendas	✓	✓	✓	✓	
3	Zhvillimi i tregut të titujve shtetërorë	✓	✓	✓	✓	
4	Hartimi dhe publikimi i një plani vjetor huamarrje	✓	✓	✓	✓	
5	Vlerësimi i mundësisë së përdorimit të alternativave të reja të burimeve të financimit (Green, Sociale etj)	Në Proces	Në Proces	Në Proces	Në Proces	

Burimi: *Ministria e Financave, 2026*

IV.2. Ecuria e objektivave specifike sasiore të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2022-2026.


Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit synon të përmirësojë më tej strukturën e borxhit (*kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm*), në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si dhe mbajtjes së kostos në nivelet më të ulëta të mundshme, bazuar në kushtet aktuale të tregut. Viti 2025 ka qenë një vit mjaft pozitiv sa i përket ecurisë së huamarrjes, dhe si rrjedhojë indikatorët e riskut kanë shfaqur përmirësim në të gjitha kategoritë krahasuar me fundin e vitit 2024, si edhe gjithashtu kanë shfaqur përmirësim krahasuar me vitin bazë të strategjisë, vitin 2021, pavarësisht përkeqësimit të ndodhur gjatë 2022.

Risku i Rifinancimit

Një ndër objektivat kryesore të SAMB është reduktimi i riskut të rifinancimit kryesisht në portofolin e borxhit të brendshëm, pasi borxhi i jashtëm paraqet më pak risk duke qenë se është i përbërë nga instrumente me afat të gjatë maturimi dhe me profile amortizimi kryesisht të shtrira gjatë në kohë. Gjatë vitit 2025, në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, Ministria e Financave ka rritur peshën e emetimeve të instrumenteve afatmesme dhe afatgjata në tregun e brendshëm dhe si rezultat, treguesit e riskut të rifinancimit kanë shfaqur përmirësim të ndjeshëm krahasuar me fundin e vitit 2025, si edhe gjithashtu kanë shfaqur përmirësim krahasuar me vitin bazë të Strategjisë (vitin 2021). Konkretisht, jetëgjatësia e borxhit të brendshëm (ditët mesatare në maturim) është rritur me 79 ditë, nga 923 ditë (2.6 vite) në fund të vitit 2024 në 1002 ditë (2.8 vite) në fund të vitit 2025, ndërkohë që krahasuar me fundin e vitit 2021 ky tregues është rritur me 209 ditë (DMM në fund të vitit 2021: 793 ditë ose 2.2 vite).

Pesha e borxhit që maturohet brenda një viti është rritur nga 39.0% në dhjetor 2024 në 39.1% në dhjetor 2025. Ndërkohë, ky tregues është në përmirësim krahasuar me vitin bazë të SAMB, ku në fund të vitit 2021 ishte 46.6%.

Grafik 3: Treguesit e Riskut të Rifinancimit




Burimi: Ministria e Financave, 2026

Risku i Normave të Interesit

Risku i normave të interesit, gjithashtu ka shfaqur përmirësim gjatë vitit 2025, kjo në rrethanat e përdorimit të shtuar të titujve afatmesëm dhe afatgjatë, si edhe emetimit vetëm të titujve me norma interesi fikse në tregun e brendshëm. Konkretisht, pesha e borxhit të cilit i rivlerësohet norma e interesit brenda vitit është ulur nga 39.3% në fund të vitit 2024 në 39.1% në fund të vitit 2025. Ky tregues është në përmirësim edhe krahasuar me vitin bazë të SAMB, ku vlerësohej në nivelin 48.0%.

Gjithashtu, edhe koha mesatare në rifiksim është rritur nga 2.6 vite në fund të vitit 2024 në 2.8 vite në fund të vitit 2025. Ky tregues është përmirësuar ndjeshëm krahasuar dhe me vitin bazë të Strategjisë, duke qenë se në vitin 2021 ky tregues është vlerësuar në nivelin 2.19 vite.

Grafik 4: Treguesit e Riskut të Normave të Interesit




Burimi: Ministria e Financave, 2026

Risku i Kursit të Këmbimit

Risku i kursit të këmbimit është mbajtur nën kontroll duke qëndruar ndjeshëm nën tavanin e përcaktuar në strategji. Konkretisht, totali i stokut të borxhit në valutë ndaj stokut të borxhit total rezultoi 40.0% në fund të vitit 2025, duke u ulur me 1.9 p.p krahasuar me fundin e vitit 2024, si dhe është ulur me 9.8 p.p, krahasuar me fundin e vitit 2021, një përmirësim i ndjeshëm. Gjatë vitit 2025 ky tregues është ndikuar pjesërisht nga nënçmimi i pjesës më të madhe të valutave të huaja, kryesisht Euros dhe USD, kundrejt Lekut dhe si rezultat i huamarrjes së re që është realizuar pothuaj tërësisht në tregun e brendshëm.

Grafik 5: Risku i Kursit të Këmbimit



Burimi: Ministria e Financave, 2026

Tabela 3: Indikatorët e Riskut

Objektiva specifike sasiore	Baseline 2021	Objektivi Strategjik 2026	Viti i Raportimit-2025			
			Statusi 2024	Statusi 2025	Aktivitetet	Komente
Përmirësimi i Riskut të Rifinancimit						
KMM borxhi i brendshëm (vite)	2.2	Min 2.5	2.56	2.8	Parashikuar një huamarrje e mbështetur gjithnjë e më tepër në tituj afatmesëm dhe afatgjatë	Gjatë vitit 2025 u mundësua mbështetja e synuar në tituj afatmesëm dhe afatgjatë që garantoj përmirësim tek treguesit e riskut
Borxhi i brendshëm që maturohet në 1 vit (% të totalit)	46.6%	Max 40%	39.0%	39.1%		
Përmirësimi i Riskut të Normave të Interesit						
KMR borxhi i brendshëm (vite)	2.19	Min. 2.5	2.58	2.8	Parashikuar huamarrje vetëm me instrumenta me normë fikse interesi	Huamarrja u realizua vetëm me instrumenta me normë fikse.
Borxhi i brendshëm norma e të cilit rifiksohet në 1 vit (% të totalit)	48%	Max 43%	39.3%	39.1%		
Përmirësimi i Riskut të Kursit të Këmbimit	49.80%	Max. 50%	41.9%	40.0%	Parashikuar që burimet e huaja të shërbejnë si plotësues të burimeve të brendshme.	Ky tregues është ndikuar nga dy faktorë si (i) nga nënçmimi i pjesës më të madhe të valutave të huaja, kundrejt Lekut dhe (ii) si rezultat i huamarrjes së re që është realizuar pothuaj tërësisht në tregun e brendshëm.

Burimi: *Ministria e Financave, 2026*